



HISTORI SUKSESI

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Qarku i Beratit dhe qyteti i UNESCO-s drejt menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve



Vend-depozitimi i ri në bashkinë e Beratit siguron që emetimet e gazit të kontrollohen dhe rrjedhjet të mos depërtojnë në lumin Osum.

Pesë bashki në qarkun e Beratit gjetën një zgjidhje për menaxhimin e mbetjeve të tyre, e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. Njësitë e reja të menaxhimit të mbetjeve, plani rajonal bashkëpunues dhe vend-depozitimet e rinovuara në Berat, Kuçovë dhe Dimal, kanë krijuar një shembull për bashkitë e tjera që aspirojnë të arrijnë menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve.

Një sfidë mjedisore

“Kur fillonte djegia e mbetjeve, ishte vërtet një katastrofë. Krijohesh një re e trashë tymi dhe era e keqe arrinte deri këtu lart,” kështu e kujton përvojën Remon Nova nga restoranti i tij në hyrje të Kalasë së Beratit, një pikë turistike e rëndësishme nga e cila shikon të gjithë qytetin.

Berati - bashkia qendrore dhe më e madhe e qarkut - është qyteti i mbrojtur nga UNESCO dhe çdo vit tërheq mijëra turistë ndërkombëtarë dhe vizitorë vendas.

Për vite me radhë mbetjet e ngurta hidheshin në zona të hapura pranë lumenjve. Kushdo mund të hynte në zonën e parrethuar dhe të hidhte mbetje, të mblidhte materiale të riciklueshme ose të vinte zjarre.

Nuk ishte vetëm ndotja e ajrit: mbetjet hynin në lumenjtë Osum dhe Devoll, dhe përfundonin në Detin Adriatik. “Mbi 90% e mbetjeve që arrinin në bregdetin e Kroacisë vinin nga jugu, kryesisht nga Shqipëria. Ndotja e Detit Adriatik është një problematikë jo vetëm për Shqipërinë dhe Kroacinë, por për të gjithë rajonin”, shpjegon Ambasadori i Kroacisë në Shqipëri, Zlatko Kramarić.

Bashkitë e patën të vështirë të gjenin një zgjidhje për shkak të mungesës së përvojës dhe financimit, dhe për shkak të mangësive në legjislacion. Në nivel kombëtar, u diskutuan disa zgjidhje por nuk u miratua asnjë model i harmonizuar i menaxhimit të mbetjeve. Pesë bashkitë e qarkut u përballën me një pyetje: si të zgjidhnin problemin e tyre të mbetjeve?

Angazhimi zviceran

Në këtë pikë, Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike, SECO, kreu një studim për sektorin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Në bazë të gjetjeve dhe me kërkesë të qeverisë shqiptare, SECO vendosi të mbështeste ndërhyrjet në qarkun e Beratit. Bashkëpunimi zviceran ishte aktiv në infrastrukturën e ujit, turizëm dhe qeverisje vendore. Diskutimet e ngushta me programin zviceran për qeverisjen vendore siguruan koherencë dhe përshtatje me kontekstin vendor.

Megjithatë, u hasën dy pengesa. Së pari, jo të gjitha bashkitë kishin vullnet për t'u përfshirë për shkak të diferencave në madhësi, në popullsi dhe në koston e asgjësimit të mbetjeve. Së dyti, megjithëse qarku kishte nevojë për një landfill të përbashkët të përhershëm, vendndodhja e tij nuk ishte identifikuar ende dhe nuk ishte rënë dakord për financimin. Kjo do të kërkonte vite.

Një zgjidhje afatmesme

Nërkohë, 100,000 tonë mbetjesh të hedhura në vend-depozitim të vjetër në Berat vazhdonin të dekompozoheshin, duke shërbyer si terren ushqimi për gjedhët dhe derrat. Gazet toksike dhe rrjedhjet po e shndërronin të gjithë zonën në rrezik për mjedisin dhe shëndetin.

Prandaj, SECO përzgjedhi një zgjidhje afatmesme: të krijoheshin kapacitete të reja, të rinovoheshin vend-depozitimet ekzistuese dhe të vendosej bashkëpunimi në të gjithë qarkun. Kjo do t'i hapte rrugën një zgjidhjeje të përhershme për qarkun. Qeveria shqiptare u bind, dha miratimin e saj dhe puna filloi.

Ngritja e kapaciteteve krahas infrastrukturës

Nëpërmjet një granti të SECO-s prej 2 milionë frangash zvicerane, projekti krijoi dhe forcoi kapacitetet bashkiake. Kjo përfshinte plane, politika, alokim buxheti dhe burime njerëzore dedikuar menaxhimit të mbetjeve të ngurta në secilën bashki.

Krahas kësaj, projekti rehabilitoi tre vend-depozitimet e pakontrolluara në Berat, Kuçovë dhe Dimal, bazuar në standarde ndërkombëtare. Punimet përfshinin mbylljen e vendgrumbullimeve për të mbrojtur ujërat nëntokësore, krijimin e sistemeve filtruese të kullimit, lidhjen me pellgjet e reja grumbulluese dhe instalimin e ventilatorëve për gazrat, ndriçimit dhe rrethimit. Bashkitë financuan 20% të këtyre masave dhe u bënë përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e vend-depozitimeve të rehabilituara.

Si hap përfundimtar, projekti krijoi bashkëpunim rajonal ndërmjet pesë bashkive në kuadër të menaxhimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të mbetjeve të ngurta. Kjo qasje bashkëpunuese ka hedhur themelet për menaxhimin e integruar kombëtar më të gjerë të mbetjeve të ngurta, sektor në të cilin qarku i Beratit është pararojë.



Riciklimi bëhet më i thjeshtë nëpërmjet koshave të rinj grumbullues në zonën e Kalasë së Beratit.

Fakte dhe shifra

- **120,000** banorë kanë qytete dhe fshatra më të pastra, dhe cilësi të përmirësuar të jetës, shëndetit dhe biznesit
- **3.5 milionë franga zviceranë** nga qeveria zvicerane: 2 milionë për kapacitete të menaxhimit të mbetjeve dhe 1.5 milionë për vend-depozitimet e reja
- **95% e qarkut** ka tashmë trajtim më të pastër të mbetjeve
- **2020:** për herë të parë mbetjet nuk hidhen më në lumenjtë Osum dhe Devoll

Një aspekt social: grumbulluesit romë

Për shumë familje rome dhe egjiptiane në Berat dhe Kuçovë, mbledhja e mbetjeve dhe riciklimi është i vetmi burim të ardhurash. Prandaj, projekti hartoi plane dhe politika për ta integruar aktivitetin e tyre dhe për ta bërë riciklimin më të sigurt dhe më të lehtë. Në Berat, u vendosën kosha të rinj grumbullues, teksa u përcaktuan edhe zonat e rrethuara për grumbulluesit informalë të mbetjeve për t'i ndarë llojet e ndryshme të mbetjeve në vend-depozitime.

Pastërtia: "A-ja" e gjithçkaje

Për autoritetet vendore, qytetarët dhe bizneset private, ndryshimi është mbresëlënës. "Falë vend-depozitimit të ri, Berati merr frymë lirshëm pasi u zgjidh problemi i vjetër 30-vjeçar i një katastrofe mjedisore, që shkaktohej nga mbetjet e hedhura në shtratin e lumit Osum, dhe Bashkia ka rritur tashmë rolin e saj të menaxhimit kur bëhet fjalë për mbetjet", shprehet kryetari i bashkisë së Beratit, Ervin Demo.

"Ka më shumë se një vit dhe e kemi harruar tymin. Po bëhet punë shumë e mirë nga Bashkia, sidomos në zonën tonë të Kalasë, ku pastërtia është e dukshme. Pastërtia është A-ja e gjithçkaje", përfundon Remon Nova, teksa sheh në drejtim të vend-depozitimit të ri.

TË DHËNA MBI BOTIMIN

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
Rr. "Ibrahim Rugova", Nr. 3/1
1019, Tiranë
Shqipëri



www.eda.admin.ch/albania



tirana@eda.admin.ch



www.facebook.com/SwissEmbassyTirana